



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 149, datë 25.11.2021

PËR

NJË NDRYSHIM NË VKB NR. 617, DATË 02.08.2019 “PËR ZGJEDHJEN E ANËTARËVE, QË DO TË PËRFAQËSOJNË KËSHILLIN BASHKIAK NË KËSHILLIN E QARKUT DHE PAJISJEN ME MANDATIN E PËRFAQËSIMIT”

Në mbështetje të nenit 113, pika 1 dhe 2, të Pjesës së Gjashtë “Qeverisja Vendore” e ligjit nr.8417, datë 21.10.1998 “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë” e ndryshuar , neni 8 , pika 2, neni 9, pika 1, nënpika 1.1 , gërma “b”, neni 54, gërma “i”, neni 55, pika 3, pika 6, dhe neni 73, të Ligjit nr. 139, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar, të Rregullores së Këshillit Bashkiak, mbështetur në raportin e Komisionit të Rregullores, Çështjeve Juridike, në mbledhjen e datës 25.11.2021,

KËSHILLI BASHKIAK
V E N D O S I :

1. Të zgjedhë si përfaqësues të Këshillit Bashkiak Durrës në Këshillin e Qarkut Durrës dhe të pajisë me mandantin e përfaqësimit z.Kastriot Xhongoli, për shkak të përfundimit të mandatit si Këshilltar Bashkiak të z.Arben Isaku.
2. Brenda 10 ditësh nga marrja e këtij vendimi të njoftohet Prefekti i Qarkut Durrës dhe Këshilli i Qarkut Durrës.

3. Ngarkohet Sekretari Këshillit Bashkiak, për zbatimin e këtij vendimi.


Ky vendim me karakter individual hyn në fuqi në datën e njoftimit të subjekteve që përfshihen në të .

KRYETARI KËSHILLIT BASHKIAK

Ani Dyrmishi



U shpall sot me datë 26.11.2021



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT DURRËS

Nr. 939/ prot.
4

Durrës, më 06.12. 2021

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit

KËSHILLIT BASHKIAK
DURRËS



Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.149 datë 25.11.2021 “Për një ndryshim në VKB Nr 617 dt 02.08.2019 “Për zgjedhjen e anëtarëve që do të përfaqësojnë Këshillin Bashkiak në Këshillin e Qarkut dhe pajisjen me mandatin e përfaqësimit”.

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI

ROLAND NASTO

